



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

MZHU sjell shërbimin online për licencat në ndërtim e projektim.

2017-07-10 14:47:00



Ministria e Zhvillimit Urban, përmes portalit **e-Albania.al** sjell një tjetër shërbim online, këtë herë për të gjithë aplikuesit për licenca profesionale të individëve dhe personave juridikë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e Studimit e të Projektimit në Ndërtim dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të zbatimit në ndërtim.

Që prej 10 Korrikut 2017, të gjithë të interesuarit për këto linceca aplikimin do ta kryejnë vetëm online, **bazuar në nenin 43, të VKM nr. 943, datë 28.12.2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave,"** për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".

Ky sistem është i dytë për e-shërbimet on-line, pas atij të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, i mundësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban.

Sistemi do të përmirësojë shërbimet ndaj qytetarëve, do të lehtësojë dhe do përshpejtojë procedurat, duke rritur më tej transparencën e sistemit midis MZHU-së dhe institucioneve të tjera publike apo edhe më gjerë.

Mes të tjerash, sistemi do të shfrytëzojë të gjithë bazën e të dhënave të informacionit dhe do të minimizojë sa më shumë të jetë e mundur ndërhyrjen njerëzore në proces, përgjatë performancës së kontrollit aritmetik dhe logjik. Këto procedura janë realizuar në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 945, datë 02.11.2012, "Për miratimin e rregullores 'Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore'", në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

Për të shkarkuar manualin [klikoni këtu](#)